



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 30.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selvie Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku dhe Agim Ademaj.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Fatmir Limaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Visar Rushiti – Gap, Suzana Gashi – IAP, Drizan Shala-Këshilltar i deputetit Armed Zemaj, Fjolla Uka- KDI, Besatra Jashari – praktikant në ZPRK, dhe Gentiana Dushi – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 05-P-036 për rishqyrtim të tekstit të Projektligjit për Kuvendin;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që të shtohet edhe pika “ Shqyrtimi i propozimit të Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike falas”.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 05-P-036 për rishqyrtim të tekstit të Projektligjit për Kuvendin

Kryesuesja e njoftoi Komisionin se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 20 tetor 2015, ka rekomanduar që Komisioni për Legjislacion ta rishikojë edhe njëherë tekstin e Projektligjit për Kuvendin dhe të marrë për bazë tekstin e Projektligjit të hartuar nga Projekti hungarez i binjakëzimit, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Lidhur me këtë ajo kërkoi nga kryesuesi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, që nënkomisioni, ta rishikojë edhe njëherë tekstin e Projektligjit për Kuvendin sipas përfundimit të Kryesisë dhe pastaj të procedojmë si Komision.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Avokatit të Popullit, në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat, kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Kryesuesja e njoftoi Komision me raportin e Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Ajo tha se fjala është për ligjin nr. 03/L-139 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-205 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Avokati i Popullit duke ushtruar të drejtën e tij kushtetuese dhe ligjore ka rekomanduar ndryshimin e disa dispozitave ligjore të këtij ligji. Pra, fjala është që si Komision, nëse pajtohemi, të merret nisma për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji. Lidhur me këtë propozoj që të formohet një grup punues që ta analizojë më në detaje raportin e Avokatit para se të vendosim si Komision.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera, Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme, në përbërje: Agim Ademaj - kryesues, Agim Aliu, Danush Ademi dhe Doruntinë Maloku -anëtarë.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryesuesja tha se sa i përket raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, ka vërejtje në amendamentet 1,4,9 dhe 14.

Amendamenti 1, ku thuhet: “Në tërë tekstin e Projektligjit të zëvendësohen fjalët: “Rregull” me “Rregullore”, “Kycje” me “Lidhje” dhe “Shkycje” me “Ndërprerje”, është shumë përgjithësues dhe nuk specifikon qartë se ku përdoret, sepse është rregull që amendamenti duhet t’i referohet qartë nenit apo paragrafit të caktuar. Kjo shkakton edhe më shumë konfuzion, nëse shikohet neni 3, paragrafi 1.19, ku jepet përkufizimi për “Rregullat” për të cilin paragraf nuk ka asnjë amendament. Po ashtu, me këtë amendamenti është bërë zëvendësimi i fjalës “Shkycje” me “ndërprerje” dhe nuk ka amendament që ka sqaruar nocionin “Rikycje” që përdoret në nenet 31 dhe 32 të Projektligjit.

Amendamenti 4, ku shtohen fjalët “dhe të miratuar nga komisioni parlamentar përkatës”, është kundërtënës sepse në nenin 5, paragrafi 2 i Projektligjit kompetent për nxjerrjen e aktit nënligjor për strukturën dhe organizimin e Autoritetit është ARRU-ja. Në një pjesë të fjalisë thuhet “i nxjerrë nga autoriteti dhe në një pjesë tjetër thuhet, miratuar nga Komisioni. Pra duhet përcaktuar qartë, cili është autoriteti kompetent për nxjerrjen e aktit nënligjor. Kjo dispozitë është rregull të përshihet në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Amendamenti 9, ku shtohet togfjalëshi “ në harmoni me ligjin” është shumë i paqartë, duhet të saktësohet me cilin ligj. p.sh. mund të thuhet “në pajtim me këtë ligj”. Kurse amendamenti 14, nuk ka bazë për procedim të mëtejshëm dhe është në kundërshtim me ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Aksionarët e ndërmarrjeve publike janë përcaktuar me ligjin për ndërmarrjet publike dhe të gjitha asetet janë në pronësi të Qeverisë apo Komunës. Ideja që asetet në pronësi publike të regjistrohen në pronësi të ofruesit të shërbimeve, është në kundërshtim me ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. E po ashtu edhe procedura e shpronësimit dhe rastet për të cilat mund të bëhet shpronësimi është e përcaktuar me Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205.

Andaj, rekomandoj që Komisionit Funksional t’i rekomandojmë që ta rishikojë raportin me amendamente me vërejtjet e paraqitura në amendamentet 1,4,9 dhe 14.

Lidhur me këtë Kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit Funksional dhe Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamenteve 1,4,9 dhe 14.
2. Komisioni për Legjislacion i rekomandon Komisionit Funksional që ta rishikojë raportin me amendamente me vërejtjet e paraqitura në amendamentet 1,4,9 dhe 14.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin 05/L-045 për Sigurimet dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit Funksional dhe Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Nezir Çoçaj duke ju referuar amendamentit 7, ku thuhet “Komisioni shtetëror i maturës është organ vendimmarrës, mbikëqyrës, organizativ, vlerësues, analizues dhe këshillues për maturën”, tha se është nocion tepër i gjerë duke i dhënë kaq të drejtë këtij Komisioni del që nuk ka nevojë për Ministri, apo edhe Komuna që sipas ligjit ka disa kompetenca në këtë fushë. Nuk dua të ndërhyj në punën e Komisionit funksional, sepse kjo edhe nuk është në kundërshtim me ligjet tjera apo kushtetutën, por si nocion i tillë në aspektin profesional nuk po me duket në rregull. Është ngarkesë për një trup që të ketë kaq shumë kompetenca, veçmas vlerësimin dhe analizimin do të duhej të bëjë dikush tjetër.

Doruntinë Maloku tha se nuk ka nevojë të lëshohemi shumë në këtë raport pasi që edhe në aspektin ligjor edhe gjuhësor është në rregull. Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit tha se pjesa e fundit e fjalisë “...dhe këshillues për maturën” del që të gjitha kompetencat e këtij komisioni që u përmenden janë vetëm për komisionin e maturës.

Armend Zemaj tha se në aspektin procedural duhet të procedojmë tutje pasi jemi në një fazë ku vlerësojmë vetëm aspektin kushtetues dhe ligjor. Si deputet kemi mundur që të japin kontributin

tonë deri sa Projektligji ka qenë në fazën e amendamentimit tani në këtë fazë mund të diskutojmë vetëm në seance plenare.

Agim Aliu tha se nuk duhet të humbim shumë kohë me këtë projektligj pasi që ne e dimë qëllimin e projektligjit edhe kur është diskutuar në parim në seancë dhe si i tillë nuk e ka realizuar qëllimin. Është keq që nuk kemi mundur dhe nuk kemi qenë pjesë e debateve për këtë ligj që t'i japim kahe tjetër, por në këtë fazë tani duhet të vlerësojmë aspektin kushtetues dhe ligjor dhe në këtë aspekt nuk ka ndonjë pengës që ta procedojmë më tutje.

Danush Ademi ngriti shqetësimin e nostrifikimit të diplomave për komunitetet boshnjake që vazhdimisht kanë probleme kur përfundojnë shkollën e mesme në vende të tjera dhe këtu kanë probleme me nostrifikimin e diplomave.

Kryesuesja duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit tha se kjo është procedurë tjetër dhe nuk ka të bëjë me këtë Projektligj dhe propozoj procedimin e Projektligjit.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se komisioni me shumicë votash vendosi që Komisionit funksional dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i propozimit të Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike falas

Kryesuesja tha se siç e dini në mbledhjen plenare të Kuvendit më 23.10.2015, bazuar në shkresën e Ministrisë së Drejtësisë nr. 01-3713 të datës 14.10.2015, ishte kërkuar të tërhiqet nga rendi ditës propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike falas nga Ministria e Drejtësisë. Bazuar në këtë, Kuvendi e kishte tërhequr në tërësi nga rendi i ditës rekomandimin e Komisionit për Legjislacion të datës 27 korrik 2015 për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, që i njëjti të kompletohet edhe me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë. Tani kemi propozimet e reja nga Ministria e Drejtësisë, ku përmes shkresës së proceduar nga Agjencia për Ndihmë Juridike falas nr. ANJF-11/15 e datës 29.10.2015 janë propozuar tre kandidatë: Baki Gimolli, Ruzhdi Osmani dhe Isuf Jahmurataj. Ajo propozoi që z. Baki Gimolli të jetë anëtar Këshillit për Ndihmë Juridike falas nga Ministria e Drejtësisë.

Komisioni në mënyrë unanime e përkrahu propozimin që z. Baki Gimolli të emërohet anëtar i Këshillit për Ndihmë Juridike falas nga Ministria e Drejtësisë.

8. Të ndryshme

Armend Zemaj propozoi që mbledhja e radhës të mbahet më 3.11.2015 në orën 11:00 pasi që mbledhjet nuk po i thërret kryetarja Komisionit dhe po detyrohem që përmes nënshkrimeve të thërrasim mbledhjen.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më. 3.11.2015, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi